

VENDIM
Nr. 820, datë 28.12.2023

**PËR AUTORIZIMIN E MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT PËR
DHËNIEN E BURSIVE NXËNËSVE TË INSTITUCIONIT ARSIMOR TË MESËM
TË ORIENTUAR “PETER MAHRINGER”, SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 39, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9522, datë 25.4.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunimin në fushat e kulturës, të arsimit dhe shkencës”, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI :

1. Autorizimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për dhënien e bursave nxënësve të institucionit arsimor të mesëm të orientuar “*Peter Mahringer*”, Shkodër, në zbatim të marrëveshjes së ratifikuar me ligjin nr. 9522, datë 25.4.2006, dhe protokollit përkatës.
2. Efektet financiare mbulohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama